



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PERMET**

Adresa: Shetitorja "Abdyl Frasheri" Permet, Gjirokaster, Albania Web: [www.bashkiapermet.gov.al](http://www.bashkiapermet.gov.al) Email : [info@bashkiapermet.gov.al](mailto:info@bashkiapermet.gov.al)

**PROCESVERBALI I TAKIMIT DATE: 14 Shtator 2022**

**VENDI:** Salla e Këshillit Bashkiak Përmet


**ORA:** 11:00

**Tema e Konsultimit:** "Menaxhimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Përmet"

**Baza Ligjore:** Ne mbeshtetje dhe ne zbatim të Ligjit Nr.146/2014 "Per njoftimin dhe Konsultimin Publik" neni 11 pika 2, Ligji Nr. 139/2015 " Per veteqeverisjen vendore", Ligji Nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", amenduar me ligjin nr.156, datë 10.10.2013, Ligjit nr.107?2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Vendimit nr.3 datë 10.06.2022 të KKT "Per miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Përmet, VKM nr.175, datë 19.01.2011 "Për Miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të menaxhimit të mbetjeve", Vendim Nr.575, datë 24.06.20215 "Për miartimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", Vendim Nr.319, Datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve, vendim nr.660, datë 31.10.2018 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve të metaleve", Vendim Nr.418, datë 27.05.2020 "Për miratimin e dokumentit të Politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035".

**Pjesëmarrës:** Kryetarja e Bashkisë Përmet znj. Alma Hoxha, Nënkryetari Z. Florand Hasani, Përgjegjësi i Sektorit të Pastrimit – Gjelbërimit Z. Petraq Vangjeli, Punonjësi i Shërbimeve Z. Arjan Jaupi, Drejtori Ekzekutiv / INFOCIP, Z. Gerti Shella, Eksperti Për Pushtetin Vendor Z. Ervis Dosti, znj. Blerina Serjani si edhe përfaqësues të bizneseve të qytetit.

**Takimi u hap nga Kryetarja e Bashkisë znj. Alma Hoxha,** e cila që në fjalën e saj hapëse evidentoi problematikën që ndesh qyteti i Përmetit me mbetjet. Pavrësisht fjalëve të mira që mund të themi, jam unë e para ajo që kam rezerva për qytetin – tha Kryetarja. Në këtë kuadër menduam që të zhvillojmë këtë konsultim bashkë me ju para se ta cojmë për miratim në Këshillin Bashkiak. Dua t'ju jam një lajm të mirë që ambasada japoneze na ka kaluar fondin në buxhetin e bashkisë, në mënyrë që të blejmë materialet e duhura për menaxhimin sa më efikas të mbetjeve. Një tjetër lajm që dua të ndaj me ju është se kemi aplikuar për një projekt tjetër për të blerë një mjet tjetër teknologjik bashkë me koshat. **Qëllimi jonë është që të kemi një rregullore për menaxhimin e mbetjeve që të ndihmojë këtë proces.**

 <p>KONSULTIM PUBLIK, Menaxhimi i mbetjeve urbane, BASHKIA PERMET, INFOCIP, STAR 3-UNDP</p>	<p><b>Minuta:</b> 00:00 -2:48, <b>Dokumentimi Audio-Video Link:</b> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc">https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc</a></p> <p><b>Konsultoni për më shumë linkun:</b> <a href="https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/">https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/</a></p>
---	---

**Z. Arjan Jaupi / Punonjës i shërbimeve-** Aktualisht menaxhimi i mbetjeve bëhet nga sektori publik. Në një të ardhme mund të menaxhohet nga sektori privat. Përsa i përket depozimit të mbetjeve në Piskovë është ndërtuar në mënyrë provizore. Vend-depozimi final do të jetë në landfill dhe për të bërë këtë duhet të kalojmë në disa faza:

***Parandalim – Reduktim – Rikuperim – Riciklim – Riperdorim – Depozitim***

Vetë rregulloja i parashikon të gjitha këto madje do jua cojmë në email për të konsultuar me materialin. **Pika kryesore ne këtë rregullore është caktimi i një orari 21:00-24:00** që gjithë sektori i pastrimit t'i shkarkojë mbetjet, cka do të thotë që pas këtyre orarve të mos depozitohen

mbetje. Faza e dyte më pas është ndarja në burim ku të krijohet infrastruktura nga ana e bashkisë për të vendosur kosha të ndarë sipas llojit të mbetjeve, por kjo do të duhet të shikohet në një moment të dytë.



**Minuta: 2:49, Dokumentimi Audio-Video Link:**  
[https://www.youtube.com/watch?v=Lq\\_neuEU-cc](https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc)

**Konsultoni për më shumë linkun:**  
<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/>

Z.Ardian Gogo - Unë jam i mendimit që ky mesazh në mënyrë që t'i përcillet sa më mirë qytetarëve të këtë një fushatë sensibilizimi, si p.sh secilit t'i shpërndahet një fletë-palosje që të ndërgjegjsohen dhe të informohen sa më mirë. Për mua ndërgjegjsimi është një nga pikat themelore në shoqëri.



**Minuta: 5:48, Dokumentimi Audio-Video Link:**  
[https://www.youtube.com/watch?v=Lq\\_neuEU-cc](https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc)

**Konsultoni për më shumë linkun:**  
<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/>


Z.Tani Qirollari- Sipas mendimit tim për bizneset është pak e vështirë kjo fashë orare për t'u respektuar. Mendoj që fasha orare të zgjatet ose të lihet orar në dy pika grumbullimi të mbetjeve.




**Minuta: 6:54, Dokumentimi Audio-Video Link:**  
[https://www.youtube.com/watch?v=Lq\\_neuEU-cc](https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc)

**Konsultoni për më shumë linkun:**  
<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/>

Z.Julian Elezi - Doja të thoja që për muajt që ka fluks , pra në muajt e veres, hotelet dhe restorantet, do të ishtë më mirë që të kishte zgjatje të fashës së orarit si edhe të ketë shtim të pikave të grumbullimit.

 <p>KONSULTIM PUBLIK, Menaxhimi i mbetjeve urbane, BASHKIA PERMET, INFOCIP, STAR 3-UNDP</p>	<p><b>Minuta: 7:50, Dokumentimi Audio-Video Link:</b> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc">https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc</a></p> <p><b>Konsultoni për më shumë linkun:</b> <a href="https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/">https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/</a></p>
--	---

Z.Vasil Nikolla - Persa i përket orarit 21:00-24:00 për të gjitha ne bizneset është i favorshëm sepse në fund të darkës i depozitojme mbetjet. Por për tre muajt që ka fluks të ketë dhe nje orar te dyte, pra për tre muajt e veres të ketë dhe një orar 3:30-4:30.

 <p>KONSULTIM PUBLIK, Menaxhimi i mbetjeve urbane, BASHKIA PERMET, INFOCIP, STAR 3-UNDP</p>	<p><b>Minuta: 8:42, Dokumentimi Audio-Video Link:</b> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc">https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc</a></p> <p><b>Konsultoni për më shumë linkun:</b> <a href="https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/">https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/</a></p>
--	---

**Kryetarja e Bashkisë:** Mendoj që orarin ta ndajme me sezone, e do të ishte gjeja më e mirë. Në verë mendoj të mos jetë ora 9 e darkës por të jetë ora 10:30. Pra në orën 10:30 fillon hedhja e mbetjeve. Duke patur parasysh diskutimet me bizneset me kane thene që ne oren 3-4 te mengjesit nuk eshtëe favorshme sepse kjo mund te ndikojë në shqetesimin e turistëve gjatë orarit të gjumit, dhe për ketë arsye nuk mendoj se duhet të kemi fashë të dytë. Ndërsa në dimër mendoj që në orën 8:00 ne darë të fillojë hedhja e mbetjeve. Përsa i përket kutive që ju bizneset i vendosni në rrugë, ju lutem hidhini në kosh. Pika tjetër ku dua të ndakem është se kur ne blem koshat e rinj ata kishin një mbishkrim “Mbyll Kapakun”. Problematika këtu qëndron më pas se mbetjet po

hëdheshin edhe sipër kapakëve. Deri tani nuk kemi përdorur si sanksion gjobën, duhet ndërgjegjësimit. Nësë nuk ndodh ndërgjegjësimi më pas do të aplikohen gjobat.

Drejtori Ekzekutiv / INFOCIP , **Z.Gerti Shella**: Plani i parë për ndërgjegjësimin dhe I dyti me pas për gjobat, dua t'ju garantoj se Qendra për Ceshtjet e Infomimit Publik / INFOCIP, e cila punon me UNDP dhe STAR 3, me shumë dëshirë do të hartojë për ju fletëpalosjet duke qënë se ju mendoni se kjo është një mënyrë e mirë, pra për këtë dua t'ju përgëzoj për organizmin e këtij konsultimi, ne na mungojnë konsultime të tilla. Vazhdoni të mbani standartin.P.sh këtë fletëpalosja mund ti bashkëkohet faturës së ujit dhe në këtë mënyrë qytetarët do të informohen lehtësisht rreth temës kaq të rëndësishme sic është mënxhimi i mbetjeve në qytetin tuaj.



**Minuta: 15:55, Dokumentimi Audio-Video Link:**  
[https://www.youtube.com/watch?v=Lq\\_neuEU-cc](https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc)

**Konsultoni për më shumë linkun:**  
<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/>

**Z.Ardian Gogo** Ideja ishte fletë-palosja por mundet që edhe të bëhen forma te tjera ndërgjegjësimit si p.sh një grup të rinjsh mund të shkojnë në cdo shtëpi, në cdo pallat dhe mund të informojnë qytetarët, mjafton që dicka të realizohet.



**Minuta: 18:00, Dokumentimi Audio-Video Link:**  
[https://www.youtube.com/watch?v=Lq\\_neuEU-cc](https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc)

**Konsultoni për më shumë linkun:**  
<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/>

**Z.Vasil Nikolla**- Edhe në pikat e grumbullimit të ketë format me shkrim ku të specifikohet orari.



**Minuta: 18:45, Dokumentimi Audio-Video Link:**  
[https://www.youtube.com/watch?v=Lq\\_neuEU-cc](https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc)

**Konsultoni për më shumë linkun:**  
<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/>

Z.Sokrat Kondili-Besoj që biznesi do të jetë gjithmone palë me bashkinë, kisha një sugjerim që diferencimi i mbetjeve në burim është gjeja e duhur, duke parë edhe vendet jashte. Si fillim mendoj të vendoseshin kosha konteniere, sipas aty mund të diferencojm plastikën,qelqin etj.



**Minuta: 19:00, Dokumentimi Audio-Video Link:**  
[https://www.youtube.com/watch?v=Lq\\_neuEU-cc](https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc)

**Konsultoni për më shumë linkun:**  
<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/>

**Kryetarja e Bashkisë:** Se pari, hapi ynë i madh është se ne do të kemi mjete teknologjike, hapi i dytë është se do t'i shtrijmë koshat në të gjitha gshatrat e luginës, dhe nuk do t'i heqim mbetjet vetëm njëhërë në javë por të paktën njëhërë në dy tre ditë. Mendoj se në orarin 15:00-17:00 të ketë një fashë tjetër, që të gjitha mbetjet që dalin në këtë orar të keni mundësi t'i hidhni. Dhe pas orës 5 ne të mos nxjerrim asnjë mbetje.

Z.Kastriot Bundo- Në orarin që nuk do të hidhen mbetje kam një sugjerim që të dalin dy tre të rinj me uniforme përkatëse, në mënyrë që nëse ndonjë shkel rregullin e orarit ta ndërgjegjsojnë.



**Minuta: 23:18, Dokumentimi Audio-Video Link:**  
[https://www.youtube.com/watch?v=Lq\\_neuEU-cc](https://www.youtube.com/watch?v=Lq_neuEU-cc)

**Konsultoni për më shumë linkun:**  
<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-njoftim-konsultim-publik-per-menaxhimin-e-mbetejve-urbane/>

**Kryetarja e Bashkisë:** Së pari, mbetjeti hedhin ose gratë ose burrat, cka do të thotë se një person madhor i kupton rregullat, ajo cka duhet të bëjmë të gjithë është të edukojmë fëmijët.

Drejtori Ekzelsiv / INFOCIP , **Z.Gerti Shella:** Nëse do të kisha mundësi do të bëja cmos që këtu në Permet të ndërtoheshin kontenieret që t'i merrnin të gjitha bashkitë e vendit duke percjellë këtë traditë pastërtie që keni ju në qytetin tuaj. Jua them me sinqeritetin më të madh që të tilla konsultime si ky i sotmi janë shumë të rrallë për t'u realizuar në qytete të tjera, duke nisur që nga kryeqyteti jone. Një nga arsyet që ne gjendemi këtu është se këto praktika të vecanta të dokumentohet dhe përmes platformave të reja që po implementohen t'i ftojme bashkitë e tjera të gjejnë modelin e këtyre konsultimeve model.

**Kryetarja mbyll takimin duke shpresuar që cdo gje do të finalizohet me sukses.**

### **FOTO – GALERIA E AKTIVITETIT**



***Për të shikuar të plotë galerinë e konsultimit kliko linkun:***

***<https://konsultimivendor.al/konsultimi-publik-per-menaxhimin-e-mbetjeve-bashkia-permet-ne-bashkepunim-me-infocip-star-3/>***

***Hartoi dhe mbajti kete procesverbal:***

Emer Mbiemer:  Edjon Maliqi- Bashkia Permet.